



Si të regjistrohet kërkesa kundër një Ndërmarrje Shoqërore në Likuidim
PYETJET MË TË SHPESHTA

Kërkesat në procedurë të likuidimit kundër një Ndërmarrjeje Shoqërore nën administrimin e AKP-së sipas Ligjit nr 04/L-034 për Agjencisë Kosovare të Privatizimit (Ligji për AKP-në)

Kreditorët potencial duhet të sigurojnë se i kanë shqyrtuar të gjithë legjislacionin relevante dhe rregulloret me kujdes, dhe të kenë shqyrtuar mundësinë e angazhimit të këshilltarit ligjor ekspert/përfaqësuesi në lidhje me çfarëdo Kërkesë që mund të kenë kundër ndonjë NSH-je në likuidim.

Ky dokument nuk e ka fuqinë e ligjit dhe nuk është më tepër se një përmbledhje e çështjeve specifike me ç'rast duhet të shqyrtohet ndonjë kërkesë e kreditorëve potencial. Ky dokument përmbledhës, për nga definicioni, nuk është gjithëpërfshirës dhe nuk i mbulon të gjitha lëmit e ligjit dhe procedurave. Nuk ka ndonjë zëvendësim për shqyrtim të ligjeve dhe rregulloreve, sidomos atyre të referuara në nenin 2 më poshtë. Kërkuesi potencial duhet të kenë vëmendjen se ky dokument nuk është ligjërish detyrues dhe nuk duhet të konsiderohet si i tillë, por duhet të konsiderohet si një këshillë ligjore themelore.

SHËNIM I RËNDËSISHËM:

Ky dokument ka të bëjë vetëm me parashtrimin e kërkesës nga ndonjë person i cili beson se ka një kërkesë kundër një NSH-je për të cilën Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka lajmëruar se do ta likuidojë në përputhje me paragrafin 9.1 të Ligjit për AKP-në.

1. Çka është likuidimi ?

Likuidimi është proces përmes të cilit AKP-ja do të trajtojë shitjen e asetëve dhe përmbushjen detyrimeve të mbetura pas privatizimit të (që kanë më tepër shanse për sukses) të NSH-së. Pas shpërndarjes së asetëve dhe detyrimeve, emri i NSH-së shlyhet nga Regjistri i Biznesit i mirëmbajtur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës dhe NSH-ja konsiderohet si e “ shpërbërë”. Asetet e NSH-së janë shitur dhe fondet e ngritura përmes realizimit të asetëve janë aplikuar për pagesë ose pagesë të pjesërishme të detyrimeve ndaj kreditorëve të NSH-së. Likuidimi pra është një metodë tjetër e privatizimit mirëpo më pak burokratike se sa privatizimi pasi që AKP-ja mund të shesë asete të vogla sikurse parcelat e vogla të tokës, mbeturinat e metaleve, magazinat ose shitoret pastaj edhe stoqet e ndryshme të një Ndërmarrjeje pa pasur nevojë për themelim të kompanisë së re siç është rasti me privatizimin.

Gjatë procesit të likuidimit çdokush që pretendon ndonjë kërkesë kundër një NSH i epet mundësia për të dorëzuar kërkesën e cila do të shqyrtohet nga një Autoritet i pavarur (i njohur si “ Autoriteti i Likuidimit”) i cili do të vlerësojë të gjitha kërkesat dhe do të lajmërojë kreditorin individual se a është pranuar kërkesa e tij. Nëse kërkesa e kreditorit është shqyrtuar dhe pranuar atëherë mund t'i bëhet pagesa kreditorit. Procesi i likuidimit i ka dy elemente; (i) shitjen e asetëve/ patundshmërisë; dhe (ii) grumbullimin, vlerësimin dhe pagesën e kërkesave. ***Ky numër i pyetjeve ka të bëjë vetëm me elementin e dytë të likuidimit ose pjesën e kërkesave.***

2. Ku mund të gjejë legjislacionin relevant në lidhje me të drejtat dhe procedurat e likuidimit të AKP-së ?

Ligjet në vijim mund të gjenden në Ueb faqen e AKP-së në www.pak-ks.org ,nën “*Ligjet & Rregulloret*”. Kjo nuk është një listë gjithëpërfshirëse e legjislacionit të aplikueshëm pasi që gjithashtu mund të aplikohen edhe ligjet civile siç është Ligji mbi Marrëdhëniet Detyimore dhe ligjet që rregullojnë marrëdhëniet pronësore juridike, Ligji për Procedurën Kontestimore etj. Ligji i aplikueshëm do të përdoret varësisht prej datave dhe natyrës së çështjes me të cilën ka të bëjë kërkesën e juaj. Për shembull, disa rregullore rregullojnë fushën e kontratave dhe obligime të NSH-së si vijon:

- a) Ligji Nr. 04/L-034 për AKP-në, Shtojca e këtij ligji
- b) Rregullorja kryesore që qeverisë me politikat e brendshme të AKP-së është “Politikat Operacionale të AKP-së” në përputhje me Nenin 10 të Ligjit për AKP-në (“rregulloret e AKP-së”).
- c) Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme shoqërore, siç ka ndryshuar përmes Rregullores së UNMIK-ut 2004/45 (“**Rregullorja e përdorimit të tokës**”).
- d) Ligji nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, (dhe amendamentet)
- d) Ligji Nr. 04/L-033 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji për Odën e Veçantë).

Ju lutemi veni re se lista e shënuar më lartë është **vetëm indikativ** dhe nuk ka si synim të jetë listë gjithëpërfshirëse e ligjeve dhe rregulloreve relevante.

3. Çka është Kërkesa e kreditorit?

Kërkesa e kreditorit është Kërkesa e bërë nga ndonjë person ose entitet i cili pretendon se NSH-ja i ka detyrim të papërbushur.

4. Si duhet të regjistroj një kërkesë të kreditorit kundër ndërmarrjes në likuidim?

Nëse keni një kërkesë në lidhje me NSH-në për të cilën është publikuar Lajmërimi për Likuidim ju duhet të regjistroni kërkesën e juaj në AKP duke plotësuar dhe dorëzuar Formularin për Dëshminë e Kërkesës (KËRKESA) në AKP.

5. A duhet të dorëzohet forma e njëjtë edhe për kërkesë pronësore ndaj Ndërmarrjes?

Jo, në rast se pretendoni ndonjë kërkesë pronësore ndaj NSH-së atëherë duhet të plotësoni formularin për Dëshminë e Interesit.

6. Si do ta kuptojë nëse është publikuar Lajmërimi për Likuidim?

AKP-ja do të publikojë apo do të kërkoj nga Autoriteti i Likuidimit publikimin e njoftimit për likuidim në gazeta të përditshme, brenda 10 ditëve të punës pas datës së vendimit për njoftimin e fillimit të procedurës të likuidimit. Lajmërimi për Likuidim gjithashtu do të publikohet në ueb faqen AKP-së.

7. Ku mund të gjejë formularët për Dëshminë e Kërkesës apo Dëshminë Interesit (KERKESA)?

Formularët e AKP-së për kërkesat në likuidim mund të gjinden në zyrën për pranim të Zyrës Qendrore të AKP-së (Prishtinë) ose në zyret Regjionale në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Pejë dhe

Gjilan. Formularët për parashtrimin e kërkesave për likuidim mund të shkarkohen prej Ueb faqes së AKP-së: www.pak-ks.org në paragrafin “Kërkesat për Likuidimit”.

8. Pse duhet të dorëzohet formularin për parashtrimin e Kërkesës për likuidim?

Ju duhet të plotësoni dhe të dorëzoni formularin për parashtrimin e kërkesës në likuidim nëse keni ndonjë kërkesë për NSH-në, duke përfshirë çfarëdo kërkesë të kreditorit (Dëshmia e Kërkesës) (pa marrë parasysh nëse është e siguar apo jo, nëse është kërkesë për dëme, kërkesë për paga të papaguara etj). Dhe kërkesë për pronësi kundër NSH-së (Dëshmia e Interesit), duke përfshirë kërkesën për pronësi të tokës ose ndonjë kërkesë që ka lidhje me ndonjë aset për të cilin mendoni se nuk është aset i NSH-së dhe për këtë shkak nuk duhet të shitet në likuidim.

Formularët për parashtrimin e Kërkesave për Likuidim duhet të dorëzohen vetëm për ato NSH për të cilat është publikuar lajmërimi për Likuidim.

9. A ka afat kohor për regjistrim të formularit për parashtrimin e Kërkesës për likuidim?

Po. Ju duhet të parashtroni Dëshmi të Kërkesës dhe/apo Dëshmi të Interesit me anë të formularit përkatës bashkë me të gjitha dokumentet mbështetëse brenda afatit për parashtrimin e kërkesave në një ditë pune 45 ditë pas datës së publikimit të njoftimit për likuidim.

10. A mund të regjistrojë një Kërkesë kundër disa NSH-ve duke përdorur një formular për parashtrimin e Kërkesës për Likuidim?

Nëse dëshironi të regjistroni kërkesë kundër disa NSH-ve të ndryshme në likuidim, ju duhet të përdorni formularë të veçanta për kërkesa të Likuidimi për secilin pretendim veç e veç ndaj secilës NSH. Nëse nuk veproni kështu atëherë kjo do të rezultojë me përjashtimin e kërkesës së juaj në likuidim të NSH-së sepse nuk janë dorëzuar kërkesat si të veçanta.

11. Ku duhet të dorëzohet formularin e plotësuar për parashtrim të Kërkesës për Likuidim?

Ju duhet të dorëzoni Formularin Dëshmisë së Kërkesës dhe/apo Dëshmisë të Interesit me të gjitha dokumentet mbështetës, Autoritetit të Likuidimit pranë zyrave Regjionale përkatëse të AKP-së Detalet e Zyrës Regjionale përkatëse të AKP-së do të jenë në Lajmërimin për Likuidim dhe Ueb faqen e AKP-së.

12. Si duhet të dorëzohet Formularin për parashtrim të Kërkesës së Likuidimit në AKP?

Ju mund të dorëzoni Formularin për parashtrimin e kërkesës për Likuidim të plotësuar në AKP me postë, korrier ose personalisht. Ju duhet të merrni edhe konfirmimin e pranimit. Formularët mund të dërgohen me faks në zyrën regjionale përgjegjëse mirëpo Autoriteti për Likuidim ka të drejtën të kërkojë origjinalin e Formës së kërkesës së Likuidimit në çdo kohë. Për këtë shkak ju këshillojmë që të dorëzoni formularin origjinale të kërkesës për Likuidim.

Me keqardhje ju informojmë se Formularët për parashtrimin e kërkesës për Likuidim të dorëzuara me e-mail nuk pranohen.

13. A duhet të paguajë ndonjë shumë parash për regjistrim gjatë dorëzimit të Formularit për parashtrimin e Kërkesës në Likuidim?

Nuk ka pagesa regjistrimi.

14. Cila gjuhë përdoret për plotësim të Formularit për parashtrimin e Kërkesës për AKP?

Gjuhët zyrtare (shqipe ose serbe). Ju nuk keni nevojë që të dorëzoni formën në të dy gjuhët. Çdo dokument shtesë duhet të dorëzohet në gjuhën origjinale (që mund të jetë gjuhë tjetër prej gjuhës shqipe ose serbe). Nëse keni përkthime ju lutemi t'i bashkëngjitni ato dhe tregoni se janë përkthime.

15. A duhet patjetër të përdoret Formularët për parashtrimin e Kërkesë për Likuidim?

Plotësimi i Formularit për parashtrimin e Kërkesës dhe bartësve të supozuar e interesit për Likuidim kërkohet sipas "Politikave Operacionale" të AKP-së, neni 7.6, nëse dështoni të dorëzoni një formular për parashtrimin e Kërkesës për Likuidim të mbështetur edhe nga dokumentet tjera në afat të duhur kohor, atëherë kërkesa juaj nuk do të jetë valide. Plotësimi korrekt i formularit për parashtrimin e kërkesave në Likuidimi gjithashtu do të mundësoj që AKP-ja të procedojë/ regjistrojë kërkesën e juaj më lehtë.

16. Cila datë konsiderohet si datë e dorëzimit të formularit për parashtrimin e kërkesës së Likuidimit në AKP?

Formulari për parashtrimin e Kërkesës së Likuidimit duhet të konsiderohet si e regjistruar / pranuar nga AKP-ja në datën kur është pranuar në selinë kryesore të AKP-së ose Zyrën Regjionale (nëse është dorëzuar personalisht ose përmes korrierit) ose data e vulës së postës (nëse është dërguar me postë).

17. Si do ta dijë nëse Formulari për parashtrimin e Kërkesës së Likuidimit është regjistruar brenda AKP-së?

Kërkesa e juaj do të regjistrohet në Zyrën Regjionale përkatëse pranë Autoritetit të Likuidimit që merret me likuidim. Ata do të ju kontaktojnë ju konform nenit 7.4 të shtojcës të ligjit për Agjencinë, Autoriteti i Likuidimit do të ju lajmëroj nëse është vlerësuar kërkesa e juaj si valide. Nëse është vlerësuar valide nga ju do të kërkohet të ofroni detalet për llogari bankare.

18. A duhet ta regjistrojë Kërkesën time nëse unë tanimë kam regjistruar një kërkesë kundër Ndërmarrjes para Lajmërimit për Likuidim?

Po, ju duhet të dorëzoni prapë kërkesën tuaj me informatat më të reja. Nevoja për të ri-dorëzuar kërkesën tuaj paraqitet për shkak se likuidimi është procedurë e re ligjore që dallon periudha e tranzicionit para fillimit të procedurës së likuidimit.

19. Çka rreth dokumenteve shtesë? A duhet ta dërgoj origjinalin apo vetëm kopjet e dokumenteve shtesë p.sh. dokumentet kadastrale, kontratat, etj? Nëse e dërgoj origjinalin a do te me kthehet prapë?

Ju duhet të dorëzoni të gjitha dokumentet relevante për të ndihmuar Autoritetin e Likuidimit në vlerësimin e kërkesës tuaj. Ju lutemi siguroni sa më tepër detale që është mundur dhe nëse është e aplikueshme ju lutemi të siguroni kopjet e kontratave, faturave, letrave përkujtuese, dëshmi gjyqësore, detale të përqindjeve të interesit, të dhëna kadastrale, leje ndërtimi etj.

Ju duhet të siguroni një listë të gjitha dokumenteve të cilat i dorëzoni dhe ta bashkëngjisni atë me dokumentet në formularin për parashtrimin e kërkesës së Likuidimit. Nëse ju mendoni se do të ndihmonte Autoritetin e Likuidimit në vlerësimin e kërkesës së juaj atëherë ju duhet të bashkëngjisni edhe një historik të shkurtër ku mund të shpjegoni arsyen e kërkesës së juaj.

Megjithatë, ju lutemi që në këtë fazë të mos dërgoni **dokumentet origjinale**. Megjithatë AKP-ja mund të kërkojë nga ju dokumentet origjinale në një fazë më të vonshme.

20. A duhet të dorëzohet përsëri dokumentacioni i dorëzuar më parë para Lajmërimit për Likuidim kur të dorëzohet Kërkesën?

Vendimi i Bordit të AKP-së që të likuiojë një NSH rezulton me ndryshim në statusin ligjor të NSH-së dhe për fat të keq do të jetë e domosdoshme të dorëzoni kërkesën tuaj me dokumentacion shtesë duke përfshirë edhe formularin për parashtrimin e Kërkesës për Likuidim.

21. A mund të kërkohej interesi?

Po, interesi mund të kërkohej në shumën e lejuar me ligj.

22. Kush do ta vlerësojë Kërkesën time kreditore?

Autoriteti i Likuidimit do të vlerësojë Kërkesën tuaj kreditore në bazë të formularit të kompletuar për parashtrimin e Kërkesës për Likuidim dhe dokumentacionit shtesë. Kjo do të aplikohet në kërkesa kreditore dhe ato që kanë të bëjnë me pronësi të aseteve individuale të NSH-së.

23. Kush do ta vlerësojë kërkesën time për pronësi ndaj Ndërmarrjes?

Bordi i AKP-së do të marrë vendimet për kërkesat pronësisë ndaj Ndërmarrjes.

24. Kush e emëron Autoritetin e Likuidimit dhe kush do të jetë anëtar i Autoritetit të Likuidimit?

Bordi i AKP-së emëron Autoritetin e Likuidimit. Në përbërje të Autoritetit të Likuidimit do të jetë: Kryesuesi, Zyrtari i çështjes, një Ofrues i Shërbimeve Profesionale, nëse Autoriteti i Likuidimit në përbërje të vet nuk do të ketë Ofrues të Shërbimeve profesionale, atëherë Bordi do të caktoj se paku një anëtarë nga komuniteti minoritarë.

25. Kur mund të presë sjelljen e vendimit nga Autoriteti i Likuidimit për kërkesën time kreditore?

Autoriteti i Likuidimit do të vlerësojë kërkesën e juaj brenda një kohe të arsyeshme dhe autoriteti do të ju lajmërojë për vendimin e marrë sa i përket pranueshmërisë së kërkesës tuaj. Ky do të jetë vetëm një vlerësim paraprak për vlefshmërinë e kërkesës suaj. Nëse Autoriteti i Likuidimit do të pranojë kërkesën e juaj, do të bëhet vlerësimi i shumës aktuale me të cilën do të paguheni dhe do të jetë i mundshëm vetëm pas vlerësimit të kërkesës së kreditorit dhe shpenzimeve të likuidimit.

26. Kur mund të presë sjelljen e vendimit për kërkesën time për pronësi ndaj Ndërmarrjes?

Vendimi për pronësi të një Ndërmarrjeje mund të sjellët vetëm nga Bordi i AKP-së dhe do t'ju komunikohet sa më shpejt që është e mundur.

Vendimet tjera për pronësi të aseteve do të sjellën nga Autoriteti i për Likuidimit dhe do t'i komunikohen pretenduesit.

27. A do ta fitojë tërë shumën e parave për të cilën pretendoj në formularin për parashtrimin e Kërkesës së Likuidimit ?

Se çfarë shume të parave ju mund të fitoni varet nga disa faktorë duke përfshirë analizën e të gjitha detyrimeve të NSH-së dhe numrin total të kreditorëve. Gjithashtu kjo varet edhe nga "prioriteti" ose klasifikimi i kërkesës së juaj. Kërkesa mund të kenë prioritete ose klasifikime të ndryshme; për shembull të gjitha kërkesat e siguruara duhet të paguhen plotësisht para se të fillojë pagesa e kërkesave të pasiguruara. Kjo do të thotë që edhe nëse Autoriteti i Likuidimit ka vlerësuar një kërkesë si valide, kreditori mund të mos ketë pranuar paratë fare dhe në shumë raste një shumë e parave mund të ndodhë që ndahet ndërmjet kreditorëve të prioritetit ose klasës së njëjtë në mënyrë proporcionale.

28. Si do të pranojë paratë e mia në rast se Autoriteti i Likuidimit pranon Kërkesën time?

Autoriteti i Likuidimit do të ju lajmërojë me shkrim nëse ata e kanë vendosur kërkesën e juaj. Nga ju kërkohet që të ofroni detale mbi llogarinë bankare në të cilën do të bëhet pagesa pas miratimit të Bordit për shpërndarjen e të ardhurave nga likuidimi. Çfarëdo pagese bankare për transfer do të zbritet nga pagesa e bërë për ju.

29. Çka mund të bëjë në rast se Autoriteti i Likuidimit e refuzon Kërkesën time?

Ju mund të kundërshtoni vendimin e Autoritetit të Likuidimit duke ushtruar ankesë në formë të shkruar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ndërmarrjet shoqërore të cilat administrohen nga Agjencia.

30. Si mund të gjejë më tepër informata për ankesë në Odën e Veçantë?

Siç është deklaruar më lartë, vendimi i Autoritetit të Likuidimit është vendimi final i AKP-së. Megjithatë, një vendim i tillë mund të sfidohet në Dhomën e Posaçme e cila ka juridiksion konform nenit 4 paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.